



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 5382

Tirane, date 3.11.2015

Drejtuar: Z. JONUZ DRAZHI
SHOQERIA "KELI - INERTE" SH.P.K
RRESHEN, QENDER E FSHATIT NDERFUSHAS, MIRDITE

LEZHE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1513 date 09.11.2010.

I nderuar zoti Drazhi,

Shoqëria "Keli - Inerte" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1513 date 09.11.2010, për bazalte, Mirdite, ne Qarkun Lezhe.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2055 date 09.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.973 date 10.02.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1513 date 09.11.2010, për bazalte, Mirdite, ne Qarkun Lezhe, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2014-2015.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit nr.1513 date 09.11.2010, për bazalte, Mirdite, ne Qarkun Lezhe, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1513 date 09.11.2010.

Ne zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKURI

